



СЛУЖБЕНИ ГЛАСНИК ОПШТИНЕ БУЈАНОВАЦ

GAZETA ZYRTARE E KOMUNËS SË BUJANOCIT

ГОДИНА - VITI VII. БРОЈ - NUMËR 8.	БУЈАНОВАЦ - BUJANOC Среда 19.06.2019 E mërkurë 19.06.2019	Издаје се по потреби Botohet sipas nevojës Цена – Çmimi 500 din.
---------------------------------------	---	--

АКТИ ОПШТИНЕ АКТЕТ Е КОМУНËС

**БУЈАНОВАЦ
BUJANOC**

Акти општинског већа Aktet e këshillit komunal

85

На основу члана 13. Став 4. Закона о подстицајима у пољопривреди и руралном развоју („Службени гласник Републике Србије“, број 10/2013 ,142/14 , 103/15 и 101/16), члана 53 Статута општине Бујановац („Сл. гласник Пчињског округа“, број 24/08), члана 39 Одлуке о Општинском већу („Сл. гласник Пчињског округа“, број 30/08).

Në bazë të nenit 13. Paragrafit 4. të Ligjit mbi stimulimet në bujqësi dhe zhvillimit rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë", numër 10/2013, 142/14 , 103/15 dhe 101/2016), nenit 53 të Statutit të komunës së Bujanocit ("Gazeta zyrtare e rrethit të Pçinjës" numër 24/08), nenit 39 të Vendimit të këshillit komunal ("Gazeta zyrtare e rrethit të Pçinjës "nr 30/08).

По прибављеном Решењу о давању претходне сагласности Министарства пољопривреде, шумарства и водопривреде (број 320-00-3478/2019-09 од 13.05. 2019.године), Општинско веће општине Бујановац , на седници од 13.06. 2019.године, доноси

Pas marrjes së Vendimit mbi dhënjen e pëlqimit paraprak të Ministrisë së bujqësisë pylltaris dhe ekonomis së ujërave (numër 320-00-3478/2019-09 nga data 13.05.2019) Këshilli komunal i komunës së Bujanocit, në seancën e mbajtur më: 13.06.2019 nxjerrë

ПРОГРАМ ПОДРШКЕ ЗА СПРОВОЂЕЊЕ ПОЉОПРИВРЕДНЕ ПОЛИТИКЕ

И ПОЛИТИКЕ РУРАЛНОГ РАЗВОЈА ЗА 2019.ГОДИНЕ. PROGRAMIN E MASAVE MBËSHTETËSE PËR REALIZIMIN E POLITIKAVE BUJQËSORE DHE POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT RURAL NË KOMUNËN E BUJANOCIT PËR VITIN 2019

I. ОПШТЕ ИНФОРМАЦИЈЕ И ТАБЕЛАРНИ ПРИКАЗ ПЛАНИРАНИХ МЕРА INFORMACIONET E PËRGJITHSHME DHE TREGIMI TABELAR I MASAVE TË PLANIFIKUARA

Анализа постојећег стања-Анализа е гјендјес
aktuale

Географске и административне карактеристике:

Karakteristikat gjeografike dhe administrative

Општина Бујановац налази се на крајњем југу Републике Србије и једна је од седам општина Пчињског округа . На југу се граничи са општином Прешево и Републиком Македонијом (гранични прелаз ка Македонији је 32 км) , на истоку са општином Трговиште, на северу са општином Врање и на западу са општинама Гњилане и Косовска Каменица.

Komuna e Bujanocit gjendet në skajin më jugor të Republikës së Serbisë dhe është njëra nga shtatë komunat e rrethit të Pçinjës. Në jug kufizohet me Komunën e Preshevës dhe me Republikën e Maqedonisë (kalimi kufitar kah Maqedonia është 32

km), në lindje me komunën e Tërgovishtes, në veri me Komunën e Vrajës, ndërkaq në perëndim me Gjilanin dhe Kamenicën e Kosovës.

Захвата површину од 461 км² на којој живи 43.302 становника, односно 94 становника по километру квадратном. Гранични прелаз ка Бугарској, 140 км – прелаз Димитровград.

Ка një territor prej 461 км² në të cilën jetojnë 43.302 banorë, gjegjësishtë 94 banorë për км². Kalimi kufitar kah Bullgaria, 140 км – kalimi në Dimitrovgrad.

Доминантне гране привреде јест пољопривреда што се може закључити на основу податка да 72. % процента становништва живи на сеоском подручју.

Degë dominuese e ekonomisë është bujqësia që mund të konkludohet në bazë të të dhënave se 72% e popullatës jetonë në zonat rurale.

Основни водоток Бујановачке котлине је река Јужна Морава. Настаје спајањем Биначке Мораве и Прешевске Моравице код Бујановца. Протиче кроз целу котлину у правцу ЈЗ - СИ. У Бујановачкој котлини, Јужна Морава је типична равничарска водоплавна река чије су обале, на појединим деловима, заштићене насипима. Водни режим реке Јужне Мораве врло је зависан од падавина и бујичног карактера притока. Биначка Морава протиче западним делом општине у дужини од око 15 км и притом прима неколико мањих притока.

Rrjedha kryesore ujqore e luginës së Bujanocit është lumi Morava Jugore, e cila formohet pasi që kësaj në afërsi të Bujanocit i bashkohet Morava e Binçës dhe Moravica e Preshevës, rrjedhë përgjatë tërë luginës në drejtimet JP-VL. Morava e Jugut është një lum që kalon në rrafshinën fushore brigjet e së cilës vende-vende janë të mbrojtura me argjinatura. Regjimi i saj ujqorë, është shumë i varur nga të reshurat atmosferike dhe të karakterit me ujqëra të bujshëm. Morava e Binçës përshkon pjesën perëndimore të Komunës në gjatësi prej 15 км dhe merr me vete disa rrjedha ujqore më të vogla (përroje).

Ток Прешевске Моравице дуг је око 26 км, од чега на територији општине Бујановац око 16 км. У овом делу тока реке Моравице подземне воде су високе. Са подручја насеља Кленике, према Ристовцу, тече Кршевичка река (бујичарског карактера), која се код Давидовца улива у Јужну Мораву. Дужина речног тока износи око 16 км. Трновачка река (која се узводно назива Брезничка, Муховска, а од изворишта Зарбинска река) извире испод Орлове Чуке (1275 м.н.в.), при чему укупна дужина тока износи око 32 км. Река Пчиња пролази југоисточним делом

општине и представља главног реципијента за воде које се одливају у Егејско море.

Rrjedha e Moravicës së Preshevës është e gjatë 26 км, e cila në territorin e Bujanocit përshkonë gjatësinë prej rreth 16 км. Në këtë pjesë të rrjedhës së Moravës Jugore ujqërat nëntokësore janë të larta. Nga zona e Klenikut, drejt Ristocit, rrjedhë lumi i Kërshevicës (me karkater të bujshëm), i cili te Davidovci derdhet në Moravën Jugore. Kjo rrjedhë përshkon gjatësinë prej 16 км. Lumi i Tërnocit (i cili në pjesën e epërme emërtohet si lumi i Breznicës, Muhocit, ndërkaq në burimin e saj i Zarbincës) rrjedhë nga Çuka e Shqiponjës (1275 m lmd.), me çrast përshkon gjatësinë prej 32 км. Lumi Pçinja kalon nëpër pjesën juglindore të Komunës dhe paraqet recipientin kryesor për ujqërat që derdhen në Detin Egeje.

На подручју општине нема природних акумулација (језера), а вештачке се налазе на реци Пчињи (400 м.н.в. од манастира Прохор Пчињски) и југоисточно од Бујановца према Божињевцу (спортско-рекреациона површина). Са аспекта извора, констатује се да су северни и јужни делови општине изразито богатији са појављивањем подземне воде (слив Трновачке и реке Пчиње), а да средишњи, висински нижи, делови општине оскудевају у извориштима подземних вода.

Në territorin e komunës nuk ka liqejë natyrorë, ndërkaq akumulimet artificiale janë në lumin Pçinja (400 m lartësi mbidetare nga Manastiri i Prohorit të Pçinjës) dhe në juglindje të Bujanocit në drejtim të Bozhinjevcit (sipërfaqe sportive-rekreative). Nga aspekti i burimeve, konstatohet se pjesët veriore dhe jugore të komunës janë mjaftë të pasura me ujqra nëntokësore (rrjedha e lumit të Tërnocit dhe Pçinjës), ndërkaq pjesa e mesme, me lartësi të ulët, pjesët e komunës kanë mungesë në burimet e ujqërave nëntokësore.

Термоминералне воде се појављују у већим количинама код насеља Раковца, око 3 км североисточно од Бујановца и насеља Левосоје, Божињевац, Жужелица и Љиљанце. Термоминерална вода у базену Специјалне болнице за рехабилитацију у Бујановачкој Бањи избија из каптажне цеви из више извора у којима кључа. Капацитет извора је знатан, при чему је прилив воде већи од отицања, па је околни терен често плавлjen. У њему се ствара пелоид (хумусно блато), по којем се ово лечилиште назива и Бујановачким (Раковачким) блатом. Температура термалне воде износи 42-43°Ц.

Ujqërat termominerale paraqiten në sasi më të mëdha në Rakoc, rreth 3 kilometra në verilindje të Bujanocit dhe në Levosojë, Bozhinjevc, Zhuzhelicë dhe Lilancë. Ujqërat termominerale në basenin e Spitalit special për rehabilitim në Banjën e Bujanocit dalin nga gypat e kaptazhit nga më shumë burime në

të cilat vlon. Kapaciteti i burimit është i konsiderueshëm, me ç'rast prurjet e ujit janë më të mëdha se dalja, andaj shpeshë ndodhë të vërshohen sipërfaqet për rreth. Në të krijohet peloidi (baltë humusore), sipas të cilës ky vend për shërim emërtohet edhe si balta e Bujanocit (Rakocit). Temperatura e ujit termal është 42-43°C.

Општину карактерише умерено континентална клима са прелазима ка медитеранској клими. Подручје се одликује топлим, сувим и сунчаним летом са око 250-300 сати сијања сунца у току летњих месеци и нешто хладнијим зимама. Просечна годишња температура ваздуха у Бујановцу износи 10,8°C, при чему је седам месеци температура изнад 10°C, док су остали месеци хладнији, са просечним температурама испод 10°C. Годишњи ток релативне влажности указује да Бујановац има умерену влажност ваздуха чија просечна годишња вредност износи 71.7%.

Komunën e Bujanocit e karakterizon klima kontinentale e cila anon kah ajo mediterane. Kjo zonë karkaterizohet me verë të nxehtë, të thatë dhe me diell veror me rreth 250-300 orë shkëlqim të diellit gjatë muajve të verës dhe me dimëra paksa të ftohët. Temperatura mesatare vjetore e ajrit në Bujanoc është 10,8°C, me ç'rast 7 muaj temperatura është mbi 10°C, ndërsa muajt e tjerë janë më të ftohët, me temperatura mesatare në 10°C. Lagështia e ajrit gjatë vitit tregon se Bujanoci ka një lagështi mesatare vjetore të ajrit prej 71.7%.

Преовлађујући ветрови у погледу снаге ветра долазе из смера североистока, севера, истока и северозапада, што је последица доминантног утицаја околних планина, превоја и речних усека који каналишу ветар у наведеним правцима. Јаки и олујни ветрови се ретко појављују у овом крају. Просечна годишња количина падавина на подручју Бујановца износи 614 мм. Највећа количина воденог талога излучује се у току пролећа и лета, са максимумом у јуну (68 мм), док се најмања количина падавина излучује у августу (42 мм).

Erërat mbizotëruese nga aspekti i fuqisë vijnë nga drejtimet e verilindjes, lindjes dhe veriperëndimit, që është kryesisht pasojë e dominimit të maleve për rreth, grykave dhe luginave të lumenjëve të cilët e kanalizojnë ajrin në këto drejtime. Erërat e forta dhe shtrëngatat janë të rralla në këtë zonë. Sasia mesatare vjetore e të reshurave në komunën e Bujanocit është 614 mm. Sasia më e madhe e të reshurave bie gjatë pranverës dhe verës (në qershor 68mm), ndërsa sasia më e vogël e të reshurave bie në gusht (42mm).

Територија општине Бујановац заузима површину од 46.100 ха, око 30 % територије је равничарско, а око 70 % је брдско-планинско

подручје. Од ове површине пољопривредно земљиште обухвата 26.523 ха или 56 %, шума 16.981 ха или 37 % и неплодно земљиште 3.424 ха или 7 %.

Territori i Komunës së Bujanocit zë një sipërfaqe prej 46.100 ha, 30% e të cilës është rrafshinë, ndërsa rreth 70% është zonë kodrinore-malore. Nga sipërfaqja e përgjithshme toka bujqësore përfshinë 26.523 ha ose 56 %, pyjet 16.981 ha ose 37 % dhe tokë jopjellore 3.424 ha ose 7 %.

Од укупне површине пољопривредног земљишта 26.523 ха, обрадиво пољопривредно земљиште (оранице и баште, воћњаци, виногради и ливаде) обухвата 17.991 ха или 67.83 %.

Nga sipërfaqja e përgjithshme prej 26.523 ha tokë bujqësore, tokë të punueshme (ara dhe kopshte, pemishtet, vreshtat dhe livadhet) përfshijnë 17,991 ha, ose 67.83%.

Поменуते површине земљиште су 84,70 % у приватној својини (индивидуалним пољопривредним газдинствима) а 15,30 % је у државној својини. Површина пољопривредног земљишта је распоређена у 59 насељених места, организованих у 29 месних заједница. Насеље општине Бујановац Приватну својину над земљиштем има 23.358 газдинстава, што по једном газдинству износи око 1.14 ха земље.

Nga sipërfaqet tokësore të cekura 84,70% janë në pronësi private (ekonomit individuale bujqësore), kurse 15.30% në pronësi të shtetit. Toka bujqësore është e shpërndarë në 59 vendbanime, të organizuara në 29 bashkësi lokale. Pronësi private të tokës kanë 23,358 ekonomi, çka i bie se për një ekonomi rreth 1.14 ha tokë.

Регистровано је 2.657 газдинстава, од тога активна су 1.710, а пасивно 947 газдинство.

Të regjistruar janë 2.657 ekonomi familjare, nga të cilat 1.710 janë aktive dhe 947 pasive.

Најплодније површине смештене су у долини Јужне Мораве и њених саставница, али је то простор који је најпогоднији за обављање свих активности, па су исте делимично заузете изграђеним објектима и комуникацијама. Удео пољопривредног у укупном земљишту опао је са 64,6 % 1964. године на 57,78 % 2006. Године, односно на 56 % 2014. године.

Sipërfaqet më të plleshme janë në ultësirën e Moravës jugore dhe të degëve të saja, mirëpo kjo është sipërfaqe më e përshtatshme për ushtrimin e të gjitha aktiviteteve, prandaj një pjesë e tyre është zënë edhe me objektet e ndërtuara dhe komunikacionin. Pjesëmarrja e tokës bujqësore në sipërfaqen e përgjithshme ka rënë nga 64,6 % në vitin 1964, në 57,78% në vitin 2006, përkatsisht në 56% në vitin 2014.

Што се тиче квалитета земљишта, заступљена су земљишта од друге до седме катастарске класе. У долиномском појасу преовлађују друга и трећа класа, док већи део територије, махом брдско-планинског карактера, покривају пета, шеста и седма класа. Стога, најповољније земљиште за аграрну производњу лоцирано је у долини река, које је најквалитетније и најплодније и где и јесу лоциране њиве и вртови па су пољопривредници оријентисани на ратарску и повртарску производњу, док земљиште на брдско-планинском терену је лошијег квалитета и у деловима који нису пошумљени погодни су за воћарство, али свакако и за сточарство.

Sa i përket kualitetit të tokës, ajo përfaqësohet nga klasi i dytë kadastral e deri në klasin e shtatë. Në brezin e ulët mbizotërojnë klasi i dytë dhe i tretë, ndërsa pjesa më e madhe e sipërfaqes, është kryesisht e karakterit kodrinor-malor, të klasit të pestë, gjashtë dhe shtatë. Andaj toka më e volitshme për prodhimtari bujqësore gjendet në luginat e lumenjëve, e cila njihërit është më kualitative dhe më e plleshme e në të cilat gjenden arat dhe kopshtijet në të cilat bujqit janë të orientuar në prodhimet lavërtare dhe perimtari, ndërkaq në terenet kodrinore-malore toka është e kualitetit të dobët dhe pjesët e papjllëzuara janë të përshatshme për pemtari dhe vreshtari dhe gjithësesi edhe për blegtori.

На обрађеним површинама земљишта гаје се различите биљне културе и то: 67,26 % ратарске културе, 9,03 % повртарске културе, 0,84 % индустријске културе, 19,70 % крмно биље, 3,05 % воћарске културе и 0,12 % винове лозе.

Në sipërfaqet e tokave të punueshme kultivohen kultura të ndryshme bimore edhe atë: kultura lavërtare 67,26 %; perimtari 9,03 %; kultura industriale 0,84 %; bimë foragjere 19,70 %; pemtari 3,05 % dhe hardhia e rrushit 0,12 %.

Ратарство на посматраном простору има дугу традицију. Оранице и баште су лоциране у долиномском појасу, до висине од 500 м, на површини од 12.071 ха.

Në sipërfaqet e përmendura lavërtaria ka një traditë të gjatë. Arat dhe kopshtijet janë të shtrira në brezin e ulët, në lartësi mbidetare deri më 500 m, në sipërfaqe prej 12.071 ha.

Повртарство је прилично значајан сегмент аграрне производње како на отвореним баштама, тако и рана производња у пластеницима. Значајне површине под крмним биљем се налазе на влажној подлози у долини река.

Perimtaria është një segment mjaft i rëndësishëm i prodhimtarisë bujqësore në kopshtijet e hapura, por edhe në prodhimtarinë e hershme në serra. Sipërfaqe të konsiderueshme të mbjellura me bimë

foragjere gjenden në bazën e lagësht në ultësirat e lumenjëve.

За аграрну производњу у општини Бујановац велики значај има производња и гајење дувана, што је у директној повезаности са индустријским сектором.

Për prodhimtarinë agrare në Komunën e Bujanocit rëndësi të madhe ka prodhimi dhe kultivimi i duhanit, që është direkt i lidhur me sektorin industrial.

Воћарство и виноградарство на територији општине углавном се јављају као споредна пољопривредна грана. Површине које заузимају воће и винова лоза су незнатне и износе свега 786 ха (3,05%) за воће, односно 33 ха (0,12 %) за винограде.

Pemtaria dhe vreshtaria në territorin e komunës së Bujanocit kryesisht paraqiten si degë dytësore e bujqësisë. Sipërfaqet e zëna me pemë dhe hardhi rrushi janë të vogla, gjithësejtë 786 ha (3.05 %) pemë, gjegjësisht 33 ha (0,12 %) për vreshtat.

С обзиром на релативно велику заступљеност пашњака и ливада у укупној структури пољопривредних површина, може се рећи да општина има релативно добре услове за развој сточарске производње, која би уз интензивирање нивоа производње и коришћења травног потенцијала представљала окосницу развоја општине. Међутим, у периоду између два пописа уочен је значајан пад сточног фонда.

Për shkak të sipërfaqeve të mëdha me kullosa dhe livadhe në strukturën e përgjithshme të tokave bujqësore, mundë të thuhet se komuna ka kushte relativisht të mira për zhvillimin e prodhimtarisë blegtorale, e cila me intensifikimin e nivelit të prodhimtarisë dhe të shfrytëzimit të potencialit të barojave paraqet boshtin e zhvillimit të komunës. Mirëpo në periudhën mes dy regjistrimeve është vërejtur një rënie e dukshme e fondit të bagëtive.

Посебна пажња се придаје развоју сектора за производњу млека и млечних прерађевина. Што се тиче производње крављег млека, у општини Бујановац дневно се произведе око 6.100 литара, док су потенцијали знатно већи и процењују се на око 15.000 литара млека дневно.

Kujdes i veçantë i kushtohet zhvillimit të sektorit të prodhimit të qumshtit dhe produkteve të tij. Sa i përket prodhimit të qumshtit të lopës, në komunën e Bujanocit prodhohen rreth 6100 litra qumësht në ditë, ndërkaq potencialet janë dukshëm më të mëdha dhe vlerësohen në 15.000 litra qumësht në ditë.

С обзиром на напред наведено, велика површина општине је повољна за пољопривредну

производњу, што уз очување пољопривредног земљишта, промену сетвене структуре, набавку технолошки савременије механизације и опреме и ефикасну примену савремених агротехничких мера може резултирати са значајним резултатима у пољопривредној производњи у наступајућем периоду.

Duke pasur parasysh të cekurat e lartëprmendura, sipërfaqet e komunës janë të favorshme për prodhimtarin bujqësore, duke ruajtjur tokën bujqësore, ndryshimin e strukturës së mbjelljeve, blerjen e makinanizmave teknologjikisht të sofistikuar dhe pajisjeve për përdorimin efikas të masave bashkëkohore agroteknike e që mund të rezultojë në rezultate të rëndësishme në prodhimin bujqësor në të ardhmen e afërt.

Удаљеност општине од већих градова - Largësia e komunës nga qytetet e mëdha

Београд	Beograd	361 км
Беч	Vjen	972 км
Будимпешта	Budapesht	732 км
Истамбул	Stamboll	767 км
Софија	Sofi	186 км
Солун	Atinë	283 км
Ниш	Nish	136 км
Скопље	Shkup	70 км
Приштина	Prishtinë	105 км

Природни услови и животна средина - Kushtet natyrore dhe mjedisi jetësor

Територијално припада Пчињском округу. Општина Бујановац се простире између 42° 15' 35" и 42° 23' 30" северне географске ширине и 21° 36' 30" и 21° 57' 00" источне географске дужине на површини од 461 км².

Territorialisht i takon rrethit të Pçinjës. Komuna e Bujanocit shtrihet midis 42° 15' 30" dhe 42° 23' 30" të gjerësis veriore dhe 21° 36' 57' 30" 00" gjatësis gjeografike lindore në një sipërfaqe prej 461 km².

Бујановац као административни центар општине се налази на надморској висини од око 400м. Највиши планински врх су „Вирови“ на планини „Козјак“ са 1.284 метара надморске висине. Бујановац лежи у котлини која је окружена побрђима. Планински врхови су: Китка (1.295м), Козјак (1.285м), Свети Илија (1.271м), Рујан (968м). Око 30% територије је равничарско, а око 70% је брдско-планинско подручје.

Bujanoci si qendër administrative e komunës gjindet në një lartësi mbidetare prej rreth 400 metra. Majat më të larta malore janë „Virovi-Dredhishtat“ në malin "Kozjak" me 1,284 metra lartësi mbidetare. Bujanocit shtrihet në një luginë të rrethuar nga kodrat. Majat malore janë: Kitka (1.295m), Kozjak (1.285m), Sveti Pija (1.271m), Rujan (968m). Rreth 30% e territorit është i rafshët, dhe rreth 70% është zonë kodrinore-malore.

Речни токови Бујановца су Моравица, Јужна Морава, Пчиња, Трновачка река, Кршевачка и Брезничка. Планира се регулација Јужне Мораве у дужини 2.300 м, Трновачке реке у дужини од око 1.700 м и регулација Крајмировске реке у дужини од око 500 м. Општина Бујановац је богата изворима минералних и термалних вода, које припадају бикарбонатном, натријумском типу и веома су квалитетна као лековита бањска вода. Поред хемијских, значајна су и геотермичка својства ових вода (температура од 43°Ц). Посебан значај има термоминерална вода Бујановачке Бање – Раковачки извор. Оваквим својим карактеристикама термалне воде Бујановца стичу карактер важног туристичког мотива за развој бањског туризма.

Rrjedhjet e lumenjve të Bujanocit janë Moravica, Morava jugore , Pçinja , lumi i Tërnocit , Krshevicës dhe Breznicës. Planifikohet rregullimi i Moravës Jugore, në një gjatësi prej 2,300 m, lumi i Tërnocit në një distancë prej rreth 1,700 m dhe rregullimin e lumit Krajmiro në një gjatësi prej rreth 500 m. Komuna e Bujanocit është e pasur me minerale dhe ujëra termal, të cilat i përkasin bikarbonateve , lloji të natriumit dhe se ata janë të cilësisë shumë të mirë, si dhe ujërave bajor kurativ . Përveç rëndësis kimike, këto ujëra janë të rëndësishme dhe për nga vetit gjeotermale (temperatura 43°C). Rëndësi të veçantë ka uji termomineral i banjës së Bujanocit-burimi i Rakocit. Karakteristikat e tilla të ujërave termale të Bujanocit marrin karakterin e një motivi të rëndësishëm turistik për zhvillimin e turizmit bajorë.

Општина Бујановац од обновљивих извора енергије има соларну енергију, енергију биомасе, енергију ветра, геотермалну енергију хидроенергију. Могућност коришћења соларне енергије нису детаљно разматране, као ни могућности коришћења ветрова првенствено на потезу према Прешевско-Кумановској превиви где непрекидно дува ветар под називом „фирке“. Од необновљивих извора енергије не поседује ни једну врсту течних или чврстих фосилних горива (нафта, земни гас, угаљ). Минерални ресурси су налазишта руда кварца, фелдспата и лискуна на локалитету Самољица и Боровац.

Komuna e Bujanocit nga burimet e ripërtëritshme të energjisë ka energjin diellore, energjin e biomasës, energjia e erës, hidrocentralet gjeotermale të energjisë. Mundësit e përdorimit të energjisë diellore nuk janë diskutuar në detaje, si dhe mundësinë e përdorimit të erës në radhë të parë për të lëvizur në drejtim të hapsirës Preshevë-Kumanovë, ku fryn era vazhdimisht e quajtur "Firka". Nga burime jo të rinovueshme të energjisë nuk posedon ndonjë lloj të lëndëve djegëse të lëngëta ose të ngurta fosilesh (naftë, gaz natyror, qymyr). Resurset minerale janë

gjetjet e shtresave të xeheve të kuarcit, feldspatit dhe mikës (biotit) në lokalitetin e Samolicës dhe Borocit.

У коритима Јужне Мораве, Љиљанске реке, Кршевичке реке и Пчиње врши се неконтролисана експлоатација песка и шљунка из речних корита која у великој мери угрожава екосистем река, као и деградацију околног пољопривредног земљишта.

Нë shtretërit e Moravës së Jugut, lumit të Lilancës, Kërshevicës dhe Pçinjës është duke u kryer shfrytëzim i pakontrolluar i rërës dhe zhavorrit nga shtretërit e lumenjve, të cilat në masë të madhe kërcënojnë ekosistemin e lumenjëve, si dhe degradimin e tokës së punueshme për reth.

Територија општине има укупно 16.981ха шума и шумског земљишта што у односу на укупне површине Општине чини шумовитост од 37%. Друштвене шуме покривају површине од 8.857ха, приватне 6.566ха, односно 43%. У структури друштвених шума провлађују изданачке шуме 73%. Високе шуме учествују са 25%. Доминантни су лишћари са учешћем од 96% и то углавном буква и храст.

Territori i komunës ka gjithësejt 16.981 ha pyje dhe tokë pyjore, çka në krahasim me sipërfaqe totale të komunës është e mbuluar me pyje reth 37%. Pyjet publike mbulojnë një sipërfaqe prej 8.857 ha, 6.566 ha private, ose 43%. Në strukturën e pyjeve publike dominojnë pyjet me bisk (llastar) 73%. Pyjet e larta përbëjnë 25%. Dominante janë drurë e fort kryesisht me një pjesëmarrje prej 96%, kryesisht ahу dhe lisi.

Стање и трендови у руралном подручју-Gjendja dhe trendet në zonat rurale

Демографске карактеристике и трендови - Karakteristikat demografike dhe trendet

Основне демографске карактеристике општине су: смањење укупног броја становника, веома изражен негативан природни прираштај, погоршање старосне структуре и виталних карактеристика популације и неповољна образовна и квалификациона структура становништва.

Karakteristikat themelore demografike të komunës janë: ulja e popullsisë së përgjithshme, një rritje natyrore negative shumë e fortë, përkeqësimi i moshës strukturore dhe karakteristikat vitale të popullsisë, kualifikimi i paknaqshëm arsimorë i strukturës së popullsisë.

Анализа структуре становништва великим добним групама указује на неповољну старосну структуру становништва, јер је највећи проценат опадања становника у старосној структури.

Analiza e strukturës së moshës te një grup i madh i popullsisë tregon strukturën e moshës të

pafavorshme të popullsisë, sepse rënia më e madhe përqindjes së banorëve është në strukturën e të moshuarëve.

Број становника општине Бујановац је у сталном опадању због неразвијености, тако да према процени Републичког завода за статистику општина Бујановац има 59 насеља, 29 месних заједница, 7 месних канцеларија и припада Пчињском округу. По последњем попису (2002. године) општина Бујановац има 43.302 становника и 10.183 становника, који су на привременом раду у иностранству. Постоји 10.936 домаћинства, то јест 94 становника по квадратном километру.

Popullsia e komunës së Bujanocit është vazhdimisht në rënie për shkak të mos zhvillimit, ashtu që në bazë të vlerësimeve të entit Republikan statistikor, Bujanoci ka 59 vendbanime, 27 bashkësi lokale, 7 zyra lokale që i takojnë rrethit të Pçinjës. Sipas regjistrimit të fundit (2002), komuna e Bujanocit ka 43,302 banorë dhe 10,183 banorë, të cilët përkohësisht punojnë jashtë vendit. Ka 10,936 amvisëri, që është 94 persona për kilometër katror.

Када је у питању етничка структура становништва,

Kur është fjala për strukturën etnike të popullatës,

- више од половине (54.68%) становника општине су Албанци,
- мë shumë se gjysma (54,68%) të popullsisë së komunës janë shqiptarë,

- Срба има око 34.13% док се од других етничких група издвајају,

- Serb ka rreth 34.13%, ndërsa grupet e tjera etnike të ndara,

- Роми који чине 8.93% укупне популације.

- Romë që përbëjnë 8.93% të popullatës së përgjithshme.

Општина Бујановац, према распореду становништва, представља већим делом рурално подручје. Ниво културне развијености је низак, што се потврђује и знатним процентом неписмених становника, који према попису 2002. године износи 10.11%, а у структури је чак 15.5% женског становништва са статусом неписменог, али од 2002 на овамо статус писмених и образованих је у сталном расту. По економској развијености, општина Бујановац спада у ред неразвијених општина у Р. Србији.

Komuna e Bujanocit, në bazë të shpërndarjes së popullsisë, është një zonë kryesisht rurale. Niveli i zhvillimit kulturor është i ulët, i cili është konfirmuar nga përqindja e konsiderueshme të popullsisë analfabete, e cila, sipas regjistrimit të vitit 2002 ishte

11.10%, struktura ishte 15.5% e popullsisë femërore me statusin analfabetor, mirpo pas vitit 2002 e tutje statusi i të shkolluarëve dhe të edukuarëve është në rritje. Sipas zhvillimit ekonomik, komuna e Bujanocit i përket komunave të pazhvilluara në R. e Serbis.

У поређењу са суседним општинама, Бујановац има спорији темпо опоравка. На основу показатеља евидентно да са смањењем броја запослених расте и процес повећања броја незапослених лица у општини Бујановац. Овај број је са 2591 у 1990. нарастао на 5338 у 2005. и порастао је за 20% више него на нивоу округа.

Краhasuar me komunat fqinje, Bujanoci ka ritmin e ngadaltë të rimëkëmbjes. Në bazë të treguesve është evidente se ulja e numrit të të punësuarve rritet dhe procesit të rritjes së numrit të të papunëve në komunën e Bujanocit. Ky numër është nga 2591 deri në vitin 1990 u rrit në 5338 në vitin 2005 dhe u rrit me 20% më shumë se në nivel rrethi.

Квалификациона, старосна и структура по полу назапослених су веома неповољне. Већина људи живи од пољопривреде.

Kualifikimi, moshja dhe struktura e të papunëve sipas gjinisë janë shumë të pafavorshme. Shumica e njerëzve jetojnë nga bujqësia.

Диверзификација руралне економије- Diversifikimi i ekonomisë rurale

Сектор пољопривреде има висок удео у запослености у руралним областима. Око 1/3 активног становништва је запослено у пољопривреди, док терцијални и секундарни сектор имају приближно исто учешће у запослености. Учешће пољопривреде у запослености одржава низак ниво диверсификације привредних делатности, као и недостатак могућности запошљавања.

Sektori i bujqësisë ka një numër të lartë të punësimit në zonat rurale. Rreth 1/3 e popullsisë aktive është e punësuar në bujqësi, ndërsa sektorët sekondar dhe terciar kanë përafërsisht të njëjtën pjesë të punësimit. Pjesëmarrja e bujqësisë në punësim mban një nivel të ulët të diversifikimit të aktiviteteve ekonomike, si dhe mungesën e mundësive të punësimit.

Пољопривреда на територији општине Бујановац представља преовлађујућу привредну делатност, са уделом око 70% у структури привреде, а карактеришу је велика заступљеност малих пољопривредних газдинстава, нижа стопа продуктивности и ниски приходи газдинстава. Велики број газдинстава су газдинства која производе за сопствене потребе са веома ниским тржишним вишковима. Број газдинстава која производе за тржиште се из године у годину постепено повећава.

Bujqësia në komunën e Bujanocit është e përfaqësuar me veprimtari ekonomike të mbizotruar, me pjesëmarrje rreth 70% në strukturën e ekonomisë, e karakterizuar nga një përfaqësim i madh i ekonomive të vogla bujqësore, normë të ulët të produktivitetit dhe me të ardhura të ulëta familjare. Një numër i madh i ekonomive prodhojnë për nevojat e tyre me tepricat shumë të ulëta në treg. Numri i ekonomive që prodhojnë për treg nga viti në vit është duke u rritur gradualisht.

Стопа незапослености је такође висока. Узимајући у обзир и преовлађујући број мањих газдинстава и високе стопе учешћа радне снаге у пољопривреди, мали број запослених (прикривена незапосленост) представља један структурални проблем пољопривреде и руралне економије.

Shkalla e papunësisë është gjithashtu e lartë. Duke marrë parasysh numrin mbizotërues të ekonomive të vogla dhe normat e pjesëmarrjes së krahut të punës në bujqësi, numri i vogël i të punësuarve (papunësia e fshehur) është një problem strukturor i bujqësisë dhe ekonomisë rurale.

Рурална инфраструктура-Infrastruktura rurale

Инфраструктура, како комунално-економска (путеви, водоснабдевање, канализациона мрежа, комуникације), тако и друштвена (образовне и здравствене установе), на задовољавајућем су нивоу.

Infrastruktura, si komunale-ekonomike (rrugë, furnizim me ujë, kanalizime, komunikim) dhe (institucioneve arsimore dhe shëndetësore) janë në nivel të kënaqshëm.

Бујановац и остала насељена места укључена у систем водоснабдевања користе пијаћу воду са подземних изворшта. Квалитет воде из ових бунара контролише се редовно од стране Хигијенског завода из Врања према предвиђеним стандардима.

Bujanoci dhe vendbanimet tjera janë të përfshira në sistemin e furnizimit me ujë duke përdorur ujë të pijshëm nga burimet nëntokësore. Cilësia e ujit nga këto puse kontrollonhet rregullisht nga Instituti i higjienës nga Vraja sipas standardeve të përcaktuara.

Због географског положаја – надморске висине у неким насељеним местима вода до корисника стиже преко станица за препумпавање воде. У оквиру система за водоснабдевање постоје следеће станице за препумпавање воде како би она стигла до корисника: В. Трновац, Лопардинце, Српска Кућа и Карадник, Цепотин, Жбевац, Спанчевац.

Për shkak të pozicionit gjeografik - nivelit të detit në disa vendbanime uji deri tek përdoruesit

arrin me anë të stacioneve për pompimin e ujit. Në kuadër të sistemit të furnizimit me ujë janë stacionet e mëposhtme për pompimin e ujit në mënyrë që të arriin deri tek shfrytëuesit : Trnovc i Madhë, Lopardincë, Srpska Kuqë dhe Karadnik, Cepotin, Žbevac, Spančevac.

Постојећи водни потенцијал није у довољној мери искоришћен о чему говори низак степен изграђености водопривредних објеката у области водоснабдевања привреде и становништва и наводњавања пољопривредних површина. Вода из водотока се користи за наводњавање само из облака , јер на територији општине нема изграженог мелиорационог система. Половина бунара су застарели и више нису за експлоатацију. Због непостојања сабирног резервоара, све инсталиране пумпе су вертикалног типа који омогућавају црпљење воде са дубина и његово препумпавање до корисника. Кућишта су подземног типа која су неприкладна и то не само за техничко - хигијенског аспекта него и за одржавање из разлога унутрашње кондензације где има доста често кварове на електроинсталацији, мотора и пумпи.

Potenciali ekzistues i ujit nuk është mjaftueshëm i përdorur, për çka flet niveli i ulët i ndërtimit të objekteve të menaxhimit të ujit në fushën e furnizimit të korporatave dhe të familjes me ujë dhe ujitjen e tokës bujqësore. Uji i freskët nga rjedhat është përdorur për ujitje vetëm nga retë , për shkak se komuna nuk ka sistem meliorativ të ujitjes . Gjysma e puseve janë të vjetëruara dhe të pashfrytëzueshme. Për shkak të mungesës së mbledhjes në rezervuare, të gjitha pompat e instaluar janë të tipit vertikal që mundësojnë pompimin e ujit nga thellësitë dhe pompimin e saj për përdoruesit. Shtëpizat janë të tipit nëntokësore që janë të papërshtatshme dhe jo vetëm për aspektet higjieniko-teknike, por edhe për të ruajtur për arsye të kondensimit të brendshëm ku ka mjaft defekte në elektro instalacion, motor dhe pompë.

Од водопривредних објеката изграђене су и две мини акумулације: «Кисела вода» (за рекреацију и туризам) и «Прохор Пчињски» (за рекреацију, туризам и производњу електричне енергије – 1 МВ).

Нга објектет е економис së ујërave janë ndërtuar edhe dy mini akumulimeve : " Kисela voda" (пër rekreacion dhe turizëm) dhe "Prohor Pçinjski" (пër rekreacion, turizëm dhe energji elektrike të prodhimit - 1 МВ).

Постојећа путна мрежа општине омогућава њену саобраћајну повезаност са окружењем.

Rrjeti ekzistues rrugor i komunës mundson lidhjet e transportit me mjedisin.

Путна мрежа општине Бујановац састоји се од 365 км категорисаних путева. У погледу привредног значаја има 32 км (8,8%) магистралних, 67 км (18,4%) регионалних и 266 км (72,9%) локалних путева. Стање путне мреже је незадовољавајуће, јер је само 51,8% путева са савременим коловозом, односно 189 км, од чега су: 32 км магистрални, 42 км регионални и 115 км локални путни правци.

Rrjeti rrugor i komunës së Bujanocit përbëhet nga 365 km të rrugëve të kategorizuara. Në shikim të rëndësisë ekonomike ka 32 km (8.8%) të autostradave, 67 km (18.4%) dhe 266 km rajonale (72.9%) të rrugëve lokale. Gjendja e rrjetit rrugor është e pakënaqshme, pasi vetëm 51.8% të rrugëve janë me rrugë moderne, ose 189 km, nga të cilat 32 km autostradë, 42 km rajonale dhe 115 km rrugë lokale .

Преко територије општине пролазе два магистрална: М-1 аутопут Београд – Скопље и М-25-3 Бујановац – Ѓњилане и четири регионална путна правца: Р-214 Београд – Скопље (паралелан са М-1); Р-125 Давидовац – Трговиште; Р-125а Света Петка – Прохор Пчињски – македонска граница и Р-125-б Бујановац – Зарбинце. Прикључак на аутопут (петља) Генералним пројектом лоцирана је северно од Бујановца.

Mbi territorin e komunës kalojnë dy magjistrale : M-1 autostrada Beograd - Shkup dhe M-25-3 Bujanoc - Gjilan dhe katër rrugë rajonale: R-214 Beograd - Shkup (paralel me m-1); R-125 Davidovc - Targovishte; R-125a Sveta Petka - Prohor Pçinjski - kufiri i Maqedonisë dhe R-125-b Bujanoc - Zarbincë. Lidhja me autostradë (mbërtheckë-lak) me projektin e përgjithshme është e vendosur në veri nga Bujanoci.

Стање магистралних и регионалних путева је веома лоше, посебно М-25.3 (ударне рупе, без ивичњака), Р-214 (6 км је макадам) и Р-214-б Бујановац-Зарбинце (од 27 км само је 5 км асфалтирано, а 22 км је земљани застор).

Gjendja e rrugëve magjistrale dhe rajonale është shumë e keqe, posaçërisht M-25.3 (gropat, pa kufizues), R-214 (6 km rrugë të shtruara me gurë) dhe R-214-b Bujanoc-Zarbinc (nga 27 km vetëm 5 km të asfaltuar, dhe 22 km është me mbules dheu).

Од 266 км локалних путева само је 115 км асфалтирано (43,2%), а остали су земљани или макадамски. Степен изграђености и незадовољавајуће стање путне мреже, нарочито је изграђено код локалних путева, где су незадовољавајући пројектни стандарди на знатном делу мреже.

Nga 266 km të rrugëve lokale vetëm 115 km të asfaltuara (43.2%), ndërsa pjesa tjetër e mbushur me zhavorr. Niveli i ndërtimit dhe gjendja e pakënaqshme e rrjetit rrugor, posaçërisht ndërtimi

tek rrugët lokale, ku standardet projektuse janë të pakënaqshëm në pjesë të konsiderueshme të rrjetit rrugor.

Елементи локалних путева су веома оскудни, јер су саграђени од материјала који не одговарају стандардима за изградњу путева.

Elementet e rrugëve lokale janë shumë të varfura, për shkak se ata janë ndërtuar nga materiale që nuk plotësojnë standardet për ndërtimin e rrugëve.

Заштита пута од површинских вода је углавном недовољна. Честе су појаве слегања насипа, нестабилности косина и настанак клизишта.

Mbrojtja e rrugëve nga ujërat sipërfaqësore në përgjithsi është e pamjaftueshme. Jane të zakonshme grumbujt e mbeturinave, paqëndrueshmëria e shpatijeve dhe rrëshqitjet.

Организованост железничког и јавног друмског саобраћаја није задовољавајућа. То се огледа у малом броју возова који стају у Бујановцу, спором одвијању превоза, малом броју полазака аутобуса, несинхронизованом реду вожње долазака путника аутобусом и возом у Врање са поласцима локалних аутобуса ка Бујановцу и Бујановачкој Бањи, неефикасно организован трансфер путника од железничке и аутобуске станице до туристичких дестинација у Општини.

Organizimi i transportit hekurudhor dhe transporti rrugor publik nuk është i kënaqshëm. Kjo është e reflektuar në numrin e vogël të trenave të ndaluar në Bujanoc, ritmit të ngadaltë të transportit, një numër i vogël i nisjeve të autobusëve, itinerar i pa hronizuar nga të të ardhurit të udhëtarëve me autobus dhe tren në Vranjë, me nisje e autobusëve lokalë kah Bujanoci dhe Vaja Bujanocit, organizimi jo efikas i transferimit të udhëtarëve nga stacioni i trenave dhe autobusëve kah destinacionet turistike në komunë.

Општина има повољан положај у оквиру железничке мреже Србије, јер кроз Бујановац пролази паневропски коридор 10, на правцу Београд-Ниш-Скопље. Преко железничке станице у Божињевцу обавља се промет робе и путника. Иако железница има велик иразвојни потенцијал, она није довољно искоришћена.

Komuna ka një vend të përshtatshëm në kuadër të rrjetit hekurudhor në Serbi, sepse përmes Bujanocit kalon koridori i 10 Pan-Evropian, në drejtim Beograd-Nish-Shkup. Përmes stacionin hekurudhor në Bozhinjec kryen lëvizjet e mallrave dhe pasagjerëve. Megjithëse hekurudha ka potencial të madh të mundshëm të zhvillimit, ajo nuk përdoret në mënyrë të mjaftueshme.

Што се тиче информатичко-комуникационе инфраструктуре, територија општине Бујановац као рурално подручје се одликује целокупном покривеношћу територије општине како фиксном тако и мобилном телефонијом (сва три оператера), тако да је приступ интернету и другим видовима информисања доступан становништву у свих десет насеља на територији општине.

Sa i përket infrastrukturës informativo - komunikuese, territori i komunës së Bujanocit si zonë rurale karakterizohet me mbulim të përgjithshëm të territorit në të dy telefonit fikse dhe atë mobile (të tre operatorëve), në mënyrë që qasja në internet dhe formave të tjera të informatave të jenë në dispozicion për qytetarët në dhjetë vendbanimet në territorin e komunës.

Показатељи развоја пољопривреде
Treguesit e zhvillimit të bujqësisë

Пољопривредно земљиште-Тока bujqësore

Територија општине Бујановац заузима површину од 46.100 ha, а од те површине пољопривредно земљиште заузима 17.991 ha, или нешто преко 87%, док обрадиво пољопривредно земљиште заузима 26.523 ha или 57 %, шума 16.981 ha или 37 % i neplodno zemljište 3.424 ha или 7 %.

Territori i komunës së Bujanocit mbulon një sipërfaqe prej 46,100 ha, nga këto zona toka bujqësore mbulon 17,991 ha ose pak më shumë se 87%, ndërsa toka e punueshme mbulon 26,523 ha ose 57% , e rujeve 16,981 ha ose 37% , tokë e pa punueshme 3,424 ha ose 7% .

Из претходно изнетог можемо закључити да је општина Бујановац изразито пољопривредна општина, тако да у структури привреде пољопривреда заузима око 70%. Територија општине има повољне земљишне, климатске и стављања у функцији одводњавања пољопривредног земљишта и повољне предуслове за наводњавање значајно већих површина од тих малих постојећих. На основу претходно изнетог, може се констатовати да на територији општине постоје сви предуслови за интензивирање ратарске, повртарске, воћарске и сточарске (комплементарна ратарској) пољопривредне производње.

Nga të cekurat e më sipër mund të konkludohet se komuna e Bujanocit është kumunë e dukshme rurale, ashtu që struktura e ekonomisë bujqësore zë rreth 70%. Territori i komunës ka tokë të favorshme, klimë dhe vënie në veprim kullimin e tokës bujqësore dhe të kushteve të favorshme për ujitje të sipërfaqeve të konsiderueshme nga ato që janë në numër të paktë. Bazuar në të cekurat e më sipërme, mund të konkludohet se në këtë komunë eksiztojnë të gjitha parakushtet për intensifikimin e prodhimit të

kulturave lavërtare, pemëtaris dhe asaj blegtorale (kulturave plotësuese).

Подручје општине Бујановац се одликује повећањем пољопривредног и посебно активног пољопривредног становништва, тако да променом сетвене структуре пољопривредних газдинстава, односно повећањем површина под повртарским усевима (посебно производња у заштићеном простору) и повећањем површина под вишегодишњим засадама (воћарска производња), за које постоје повољни природни услови, може се значајно унапредити производња поготово мањих пољопривредних газдинстава, како би производили што више пољопривредних производа за тржиште, а мање за сопствене потребе.

Komuna e Bujanocit karakterizohet me një rritje në popullsinë bujqësore edhe ate veçanarisht të atyre aktiv , ashtu që me ndryshimin e strukturës mbjellëse të ekonomive bujqësore, përkatësisht një rritje në zonat nën kulturat bimore (sidomos prodhimtaria në serë) dhe rritjen e sipërfaqeve të pemishteve (prodhimtaria e frutave), për të cilat eksiztojn kushtet e favorshme natyrore , mund të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme prodhimtaria e posaçërisht tek ekonomit e vogla bujqësore, në mënyrë që të prodhojnë më shumë produkte bujqësore për tregun se sa për nevojat e tyre.

Земљиште општине Бујановац се одликује присуством великог броја типова земљишта : чернозем, ливадске црнице, ритска земљишта, слатине и песковита земљишта.

Toka e komunës së Bujanocit është e karakterizuar nga prania e një numri të madh të llojeve të tokës: çernozem, tokë livadhore (e zezë), tokë kënetore, minerale dhe tokat ranore.

-Пољопривредно земљиште и његова структура према подацима РГЗ-катастра непокретности Бујановац за 2015.годину:

-Тока бујкësore dhe структура e saj në базë të të dhënavе ERGJ- kadastrë të patundshmërive Bujanoc për vitin 2015:

Катастарска култура	Површине (ha)
Њиве- Arat	15.194,3775
Вртови- Kopshtiet	38,1964
Воћњаци- Pemishtet	633,7185
Виногради- Vreshtat	440,8011
Ливаде- Livadhet	1.699,5905
Обрадиво пољопривредно земљиште	17.991,5905
Токë e punueshme bujqësore	
Пашњаци Kullotat	8.520,7302
Трстици-мочваре	11,6158

Kallamishtet-Kënetat	
Укупно пољопривредно земљиште:	26.523,9365
Sipërfaqja e përgjithshme bujqësore:	

Вишегодишњи засади-Тë mbjellurat shumëvјçare

Територија општине има изразито погодне природне услове (адекватна земљишта, погодну климу, потенцијал-присутност воде за наводњавање) и едуковану радну снагу за развој воћарско-виноградарске производње. У задњих неколико година долази до значајног повећања заинтересованости пољопривредних произвођача за подизањем вишегодишњих засада воћа (првееенствено засада јабуке, вишње и шљиве) из разлога отварања источног тржишта, тако да поменуте воћарске поизводње уз изградњу објеката за смештај и чување (хладњача) могу дати значајан допринос развоју општине. С обзиром да не постоје прецизни и ажурирани катастарски подаци о површинама под културом воћњак и виноград, али имамо статистике са пописа пољопривреде 2012. Само у последњих 2-3 године по нашим проценама је подигнуто преко 30 ha интензивних засада јабука, вишања и шљиве које добијено из Швајцарске Владе и Европске уније као донација, те је по нашем мишљењу потребно пољопривредним произвођачима пружити различите видове подршке, како би се лакше одлучили на подизање вишегодишњих засада.

